



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Numri i lëndës: 2022:051680
Datë: 26.09.2024
Numri i dokumentit: 06214529

K.DH.SH.II.nr.993/24

Gjykata Komerciale e Kosovës-Dhoma e Shkallës së Dytë në Prishtinë, me gjyqtaren Franciska Zhitija Ymeri, në çështjen përmbarimore të kreditorit “E...” Shpk, me NUI:, me seli në Ferizaj, kundër debitorit N.H. “... & L” me NUI:, me seli në Ferizaj, duke vendosur lidhur me ankesën e debitorit, të ushtruar kundër aktvendimit të Gjykatës Komerciale të Kosovës, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike KPPP.nr.1465/23 i datës 30.11.2023, me datë 23.09.2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

REFUZOHET e pa themeltë ankesa e debitorit N.H. “... & L” me seli në Ferizaj, e datës 11.01.2024, ndërsa Aktvendimi i Gjykatës Komerciale të Kosovës, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike KPPP.nr.1465/23 i datës 30.11.2023, VËRTETOHET.

A R S Y E T I M

Gjykata Komerciale e Kosovës, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, me Aktvendimin e ankimuar, KPPP.nr.1465/23 i datës 30,11,2023 , ka vendosur si në vijim: nën pikën I. Refuzohet në tërësi si i pa bazuar prapësimi i debitorit N.H. “... & L” i ushtruar kundër Urdhrit Përmbarimor P.nr.133/2022 i datës 09.03.2022 të Përmbaruesit Privat

Besnik H. Aliu. Nën pikën II. Mbetet në fuqi Urdhri Përmbartimor P.nr.133/2022 i datës 09.03.2022 i Përmbartuesit Privat Besnik H. Aliu.

Kundër këtij aktvendimi, në afatin ligjor ka paraqitur ankesë debitori, për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës përmbartimore, vërtetimit jo të plotë dhe të gabuar të gjendjes faktike dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale. Me propozim që të aprovohet si e bazuar ankesa e debitorit NH “.... & L” me NUI:, rruga Ferizaj i paraqitur kundër Aktvendimit të Gjykatës Komerciale Dhoma e Shkallës së Parë KPPP.nr.1465/23 të datës 30.11.2023, të ndryshohet aktvendimi i Gjykatës Komerciale Dhoma e Shkallës së Parë KPPP.nr.1465/23 të datës 30.11.2023, duke anuluar Urdhrin për përmbartim dhe të prish aktvendimin KPPP.nr.1465/23 të datës 30.11.2023, të prishet aktvendimi i Gjykatës Komerciale Dhoma e Shkallës së Parë KPPP.nr.1465/23 të datës 30.11.2023, dhe i njëjti ti kthehet Dhomës së Shkallës së Parë në rivendosje, duke caktuar gjyqtar tjetër gjykues. Kërkojmë shpenzimet për përpilimin e ankesës 340 euro sipas TOAK dhe taksat gjyqësore.

Përgjigje në ankesë nuk është paraqitur.

Gjyqtarja individuale e Dhomës së dytë të Gjykatës Komerciale, i shqyrtoi shkresat e lëndës, aktvendimin e ankimuar, pretendimet ankimore dhe pas shqyrtimit të tyre, konform nenit 3 paragrafi 2 të Ligjit të Procedurës Përmbartimore si dhe në kuptim të nenit 194 të LPK-së, gjeti se:

Ankesa e debitorit është e pa themeltë.

Nga shkresat e lëndës rrjedh se kreditori: “E...” ShPK, me seli në Ferizaj, me datë 09.03.2022, ka paraqitur propozim për përmbartim ndaj debitorit N.H. “.... & L” me seli në Ferizaj, në bazë të dokumentit të besueshëm, faturës, debitori ka qenë i obliguar që ti paguaj kreditorit shumën 7,771.10€. Kreditori ka kërkuar nga debitori që të bëjë pagesën e të njëjtave, mirëpo i njëjti nuk e ka kryer-paguar borxhin, provë, fatura nr.003487 e datës 01.12.2020 në shumë prej 2,771.10€ dhe fatura nr.003465 e datës 08.06.2020 në shumë prej 5,000.00€. meqenëse debitori edhe përkundër kërkesave të kreditori nuk e ka përmbushur obligimin –borxhin në afatin e caktuar si në dokumentin e besueshëm-fatura kemi propozuar që Përmbartuesi Privat të nxjerr urdhër me të

cilin urdhërohet debitori që nga dita e pranimit të këtij Urdhri ti paguaj kreditorit shumën prej 7,771.10€ me kamatë ligjore prej 8% nga dita e paraqitjes së propozimit për përmbardim e deri në pagesën definitive dhe shpenzimet e procedurës përmbardimore, sipas UA-MD.nr.06/2014 aq sa do të shkaktohen deri në përfundimin e procedurës përmbardimore, ashtu që përmbarduesi borxhin do ta inkasoi me –Bllokimin dhe ndalimin e mjeteve në para të cilat debitori i ka në llogaritë bankare në të gjitha bankat komerciale në Kosovë në bartjen e shumës përkatëse në llogarinë e veçantë të përmbarduesit privat, -regjistrimin, sekuestrimin, vlerësimin dhe shitjen e sendeve të luajtshme dhe të paluajtshme të debitorit ashtu që të paguhet borxhi i kërkuar nga kreditori.

Ndaj këtij urdhri, me datë 14.03.2022, debitori ka paraqitur prapësim, duke e kontestuar në tërësi si të pa bazë urdhrin e përmbarduesit privat Besnik Aliu P.nr.133/22 të datës 09,08,2022 kinse për mos pagesën e borxhit në shumë prej 7,771.10€ i cili është plotësisht i pa bazë dhe në kundërshtim me dispozitat ligjore të LPP me çka e kundërshton propozimin e përmbardimit pasi që është pa kurrfarë baze ligjore, në radhë të parë propozimi për përmbardim është i pa rregullt dhe jo ligjor nga ka hyr subjekti L.M. BI ku shihet qëllimi i keqpërdorimit qysh në fillim të propozimit. Andaj propozoj Gjykatës që të aprovet prapësimi i debitorit ashtu që të pezullohet propozimi për përmbardim P.nr.133/22 i datës 09.03.2022 derisa të sqarohen të gjitha rrethanat, urdhri për përmbardim të hedhet poshtë si i pa bazuar me ligj si në thëniet më lart. Propozoj caktimin e mbajtjes së një seance gjyqësore në gjykatë dhe kërkojmë shpenzimet për përpilimin e përgjigjes-prapësim 312 euro.

Dhoma e Shkallës së Parë, pas vlerësimit të prapësimi të debitorit, me aktvendimin e atakuar, KPPP.nr.1465/23 të datës 30.11.2023, ka refuzuar prapësimin e debitorit duke vendosur më decidivisht si në dispozitiv të të njëjtit.

Dhoma e Shkallës së Parë, në arsyetimin e aktvendimit të ankimuar ndër të tjera ka theksuar se në rastin konkret gjykata vlerëson se urdhri i lejuar nga ana e përmbarduesit privat bazohet në dokumentin e besueshëm faturën nr.003465 të datës 08.06.2020, faturën nr.003487 të datës 01.12.2020, të cilat i përmbajnë të gjitha tiparet e dokumentit të besueshëm sipas nenit 29 par.3 të LPP-së, meqenëse në këto fatura, janë treguar palët, përkatësisht kreditori dhe debitori, janë të përshkruara mallrat të cilat kanë qenë objekt i faturave, është përcaktuar shuma e cila është

detyrim për përmbushje nga ana e debitorit si dhe të njëjtat janë pranuar nga debitori në mënyrë të rregullt, e cila vërtetohet nga vula dhe nënshkrimi i debitorit. Rrjedhimisht, gjykata vlerëson se në rastin konkret faturat e lartcekura i plotësojnë kushtet e përcaktuara në nenin 37 të LPP, për zbatimin e përmbartimit në bazë të dokumentit të besueshëm, pasi që të njëjtat janë dorëzuar në origjinal, mbajnë vulën dhe nënshkrimin e pranimi të debitorit. Andaj duke u bazuar në të lartcekurat, gjykata lidhur me këtë çështje përmbartimore vlerëson se nuk ekziston asnjëra nga bazat ligjore mbi bazën e të cilave do të mund të anulohet urdhri për lejimin e përmbartimit nga shkaqet e parashikuara në nenin 71 të LPP-së, ndërsa në kuptim të nenit 73 par.1 të LPP-së lidhur me prapësimin e debitorit ka vendosur jashtë seancës gjyqësore.

Vlerësimin dhe qëndrimin juridik të Dhomës së Shkallës së Parë, Dhoma e Shkallës së Dytë e Gjykatës Komerciale, e aprovon si të rregullt dhe të ligjshëm, për arsye se aktvendimi i atakuar nuk është përfshirë me shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2, pika b), g), j), k) dhe m), të LPK-së, dhe se drejtë është zbatuar e drejta materiale, e të cilat shkaqe ankimore Dhoma e Shkallës së Dytë, në bazë të nenit 194 të LPK-së, i vlerëson edhe sipas detyrës zyrtare.

Dhoma e shkallës së dytë, vlerëson se nuk qëndrojnë pretendimet se urdhri përmbartim është i parregullt dhe jo ligjor dhe as pretendimet për gjendjen faktike sepse gjykata në procedurë përmbartimore e vlerëson përshtatshmërinë e dokumentit të besueshëm, vlerëson nëse janë plotësuar kushtet për nxjerrjen e urdhrit përmbartimor dhe a ekzistojnë ndonjëra nga shkaqet për prapësim nga neni 71 i LPP-së.

Dhoma e shkallës së dytë, vlerëson se në rastin konkret, përmbartimi i lejuar me anë të dokumentit të besueshëm - faturës në të cilën është mbështetur Dhoma e Shkallës së Parë, e që vlerësohet si e drejt nga kjo Dhomë e shkallës së dytë, ngase duke u bazuar në dispozitat ligjore nga neni 29 paragrafi.1 pika 1.3 dhe paragrafi. 3 të LPP-së me të cilin theksohet se: *“1. Përmbartimi me qëllim të realizimit të kërkesës në të holla caktohet edhe në bazë të dokumentit të besueshëm. Dokument i besueshëm, sipas këtij ligji është: 1.3. faturat; ndërsa paragrafi. 3. Dokumenti i besueshëm është i përshtatshëm për përmbartim po qe se në të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, lloji, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit monetar., e që nga kjo dispozitë shihet çartë se dokumenti me të cilin kreditori e ka kërkuar përmbartimin është i besueshëm, në të është*

treguar kreditori dhe debitori, shuma e cila duhet të paguhet, dhe se e njëjta është pranuar dhe nënshkruar nga ana e debitorit.

Kjo Gjykata vlerëson se Dhoma e Shkallës së Parë drejtë ka zbatuar dispozitat e LPP-së, kur ka refuzuar prapësimin e debitorit të paraqitur kundër urdhrin mbi lejimin e përmbarimit, ngase edhe sipas vlerësimit të Dhomës së Shkallës së Dytë dhe sipas shkresave të lëndës konstatohet se përmbarimi është lejuar në bazë të dokumentit të besueshëm – faturës nr.003487 e datës 01.12.2020 në shumë prej 2,771.10€ dhe faturës nr.003465 e datës 08.06.2020 në shumë prej 5,000.00€, i cili në mbështetje të dispozitave nga nenin 29 paragrafi 1 pika 1.3 dhe par 3 të LPP-së, e kanë cilësinë e dokumenteve të besueshme.

Dhoma e Shkallës së dytë vlerësoj pretendimet ankimore, lidhur me at se aktvendimi i ankimuar është në kundërshtim me provat e paraqitura nga debitori një pretendim të till kjo gjykatë e refuzoj si të pa pabazuar ngase në prapësimin e paraqitur nga debitori nuk figuron se ka bashkangjitur prova në kuptim të kundërshtimit të tij në mënyrë që gjykata e shkallës së parë të ketë anashkaluar dhe mos analizuar provat e debitorit. Po ashtu dhoma e shkallës së dytë e Gjykatës Komerciale, i vlerësoi edhe të gjitha pretendimet e tjera ankimore por të njëjtat nuk ishin me ndikim për një vendim ndryshe, për çka vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi. Nëse pala debitore për çfarëdo rrethane apo arsye pretendon se pala kreditore kërkon përmbarimin e detyrimit pa bazë ligjore, si shkak i të cilave palës debitore eventualisht ka mundur ti shkaktohet apo mund ti shkaktohet çfarëdo lloji dëmi më rastin e kryerjes se përmbarimit sipas kësaj lënde, nuk ka pengesa ligjore që lidhur më këtë të drejtën e tij ta realizoj në kontest të rregullt civil pranë gjykatës kompetente.

Nga të cekurat u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi në bazë të nenit 209 pika b) të LPK-së.

GJYKATA KOMERCIALE NË PRISHTINË-Dhoma e Shkallës së Dytë

K.DH.SH.II.nr.993/24, me dt. 23.09.2024

Gjyqtarja

Franciska Zhitija Ymeri